



Prishtinë, 29 Dhjetor 2009

Kodi i ZRRE-së: V_217_2009

Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energji, duke u bazuar në:

- Nenet 15 dhe 26 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë Nr.2004/9 të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Rregullin për procedurën e autorizimit për Ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gasit, linjave direkte elektroenergetike dhe linjave gypore direkte;
- Vendimin për Autorizimin preliminar, lëshuar nga Zyra e Rregulatorit për Energji (ZRRE) për kompaninë Wind Power Sh.a, me datë 22 shtator 2009;
- Kërkesën për shndërrimin e Autorizimit preliminar në Autorizim, të kompanisë Wind Power sh.a, me adresë: Bulevardi i Dëshmorëve të Kombit, Ulpianë nr. 68/9, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
- Lejet, pëlqimet dhe vendimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në Shtojcën II të këtij Vendimi,

në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2009 nxori këtë :

VENDIM
PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

Kompanisë Wind Power Sh.a, i lëshohet **AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) - era, që përbëhet prej tri (3) turbinave, secila me nga 450 kW, me kapacitet instalues të tërësishëm prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, zona kadastrale Harilaq, KK Fushë Kosovë.

Arsyetim

1. ZRRE me datë 03.03.2009 nga kompania **Wind Power sh.a** (tani e tutje **aplikuesi**), ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim e kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) - era , që përbëhet prej tri (3) turbinave, secila me nga 450 kW, me kapacitet instalues të tërësishëm prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, zona kadastrale Harilaq, KK Fushë Kosovë.
2. ZRRE pas konstatimit se Aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë nga era me kapacitet instalues prej 1.35 MW, me datë 22 shtator 2009 ka lëshuar Vendimin mbi Autorizimin Preliminari dhe ka udhëzuar Aplikuesin që t'i plotësojë kushtet tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

ZRRE, pas pranimit të dokumenteve të fundit origjinale të kërkua me Vendimin e ZRRE-së të datës 22 shtator 2009, dhe pas vlerësimit të tyre dhe shkresave të tjera të

3. bashkangjitura aplikacionit, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
4. Ky Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkangjitur këtij Vendimi janë:

Shtojca I : Autorizimi për ndërtimin e kapacitetit gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet instalues prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, zona kadastrale Harilaq, KK Fushë Kosovë.

Shtojca II: Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave, etj.) të lëshuara nga institucionet e Kosovës.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtar

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar



Prishtinë, 29 dhjetor 2009

Kodi i ZRRE-së: V_217_2009

SHTOJCA I

Zyra e Rregulatorit për Energji (ZRRE, duke ushtruar kompetencat e dhëna me nenin 38 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 14 të "Rregullit për procedurën e autorizimit për Ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gasit, linjave direkte elektroenergetike dhe linjave gypore direkte", kompanisë Wind Power sh.a, me adresë 'Bulevardi i Dëshmorëve të Kombit', Ulpianë, nr. 68/9, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, lëshon këtë

AUTORIZIM

Për ndërtimin e kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE)-era, që përbëhet prej tri (3) turbinave, secila me nga 450 kW, me kapacitet instalues të tërësishëm prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, zona kadastrale Harilaq, KK Fushë Kosovë.

1. Me këtë Autorizim autorizohet kompania Wind Power sh.a, që të ndërtojë kapacitetin gjenerues në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Autorizim.
2. Ky Autorizim do të vlejë për dy vjet, duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE, me kërkesë të palës, mund ta vazhdojë vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
 - a) të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim,
 - b) të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë, përfshirë edhe ato për mjedisin.
4. ZRRE mund ta bëjë modifikimin e këtij Autorizimi në përputhje me dispozitat për modifikim të përcaktuara me Rregullit për procedurën e autorizimit për Ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergetike dhe linjave gypore direkte.
5. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të **pezullohet** dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur marrëveshje të kënaqshme që mund ndikojnë në térheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të Autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt ndaj palës së Autorizuar mund të ndermirëن masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
6. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundojë me skadimin e afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij Autorizimi, apo me skadimin e afatit tjeter të përcaktuara nga ZRRE e në përputhje me pikën 4. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërsës prej kushteve të këtij Autorizimi apo bën shkelje të dispozitave të "Rregullit për procedurën e autorizimit për

Ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergetike dhe linjave gypore direkte”, atëherë ZRRE mund ta anulojë Autorizimin në përputhje me dispozitat e këtij Rregulli që kanë të bëjnë me anulimin e Autorizimit. Nga data e anulimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar gjenerues do të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjisacionin në fuqi.

7. Pala e autorizuar duhet ta njoftojë me shkrim ZRRE-në dhe të kërkojë pëlqimin paraprak për çdo ndërrim të ndonjë pjese të elementeve ekzistuese të gjeneratorëve apo shtim të elementeve të reja, e që nuk janë të përfshira në aplikacionin fillestar.
8. Para lëshimit në punë të njësive gjeneruese, kompania Wind Power dhe KEK sh.a –Divizioni i Furnizimit duhet të lidhin Marrëveshjen për Blerje të Energjisë (MBA) dispozitat e së cilës duhet të miratohen dhe monitorohen nga ZRRE siç përcaktohet me Nenin 21.6 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Në emër të Bordit të ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti
Kryesues i Bordit të ZRRE-së



Prishtinë, 29 dhjetor 2009

Kodi i ZRRE-së: V_217_2009

SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave, etj.), të lëshuar nga institucionet e Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimin** për ndërtimin e kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE)-era, që përbëhet prej tri (3) turbinave me nga 450 kW, e që në tërësi ka kapacitet instalues prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, zona kadastrale Harilaq, KK Fushë Kosovë për kompaninë Wind Power sh.a, me adresë ‘Bulevardi i Dëshmorëve të Kombit’, Ulpianë, nr. 68/9, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

- **Leja për vendosje të ananometrave**- e lëshuar me Aktvendim nr.207 i datës 19.12.2008 nga Drejtori për planifikim urban, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit e KK Fushë Kosovë;
- **Konkluzion** nr. 565 i datës 11.08.2009, i lëshuar nga Drejtori për planifikim urban, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit e KK Fushë Kosovë, me të cilin ndryshohet Aktvendimi nr. 207 i datës 19.12.2008;
- **Vendim për Pëlqim Mjedisor**, nr. 08/1919/3-ZSP-1928 e datës 04.12.2008 lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- Komunikata e datës 16.10.2009 e lëshuar nga MMPH-ZSP lidhur me lëshimin e **Lejes Ekologjike**.
- **Kontrata për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës**, e lidhur mes Wind Power sh.a dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);
- **Pëlqimi për shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore për prodhim të energjisë elektrike nga era**, nr. Ref:KE-866/08 taë datës 26.09.2008 të lëshuar nga Agjencisë Pyjore të Kosovës, MBPZHR dhe kompanisë Wind Power sh.a;
- **Pëlqimi elektroenergetik i KEK sh.a**, me nr. 6105 i datës 31.10.2008 lëshuar kompanisë Wind Power sh.a;
- **Leja për kyçje**, e lëshuar nga KEK sh.a-Divizioni i shpërndarjes, me nr. 5337 i datës 16.10.2009, me të cilën i lejohet kompanisë Wind Power sh.a që përkohësisht të kyçet në kthinën e veçantë 10 (20) kV në TS 35/10 kV Vrellë;
- **Shkresa e Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC)**, e datës 30.11.2009 lidhur me pengimin potencial të turbinave me erë në operimin e Aeroportit Ndërkombëtarë të Prishtinës (ANP);
- Kopje e **Raportit të Aeroportit Ndërkombëtarë të Prishtinës (ANP)** lidhur me vlerësimin teknik mbi efektet e “turbinave me erë” në sistemin e komunikimit, navigimit dhe vëzhgimit të ANP.